



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:196698

Datë: 14.03.2025

Numri i dokumentit: 06992953

**C.nr.1352/2017**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi, në çështjen juridike të paditësve Sh.F. dhe E.D. të cilët i përfaqëson avokat F.M., avokat në Prishtinë, ndaj të paditurës K.S. S., me seli në Prishtinë, me objekt të kontesit: anulimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me datë 14.03.2025 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve Sh.F. dhe E.D. me të cilën kanë kërkuar që të anulohet marrëveshja jashtëgjyqësore me numër 0243-92-17 e datës 13.04.2017 dhe marrëveshja jashtëgjyqësore me numër 0144-02-17 e datës 13.04.2017 dhe të detyrohet e paditura K.S.S. që paditësve në emër të dëmit material dhe dëmit jomaterial tua paguajë shumat si në vijim: paditësit Sh.F.: për dhimbje fizike shumë prej 2,000.00 euro, për frikë shumë prej 2,000.00 euro, për ndihmën e huaj shumë prej 600.00 euro, për ushqim të përforcuar shumë prej 600.00 euro, për shpenzime të shërimit shumë prej 300.00 euro, për rehabilitim fizioterapeutik dhe klimatik shumë prej 600.00 euro dhe për paditësin E.D.: për dhimbje fizike shumë prej 2,000.00 euro, për frikë shumë prej 2,000.00 euro, për ndihmën e huaj shumë prej 600.00 euro, për ushqim të përforcuar shumë prej 600.00 euro, për shpenzime të shërimit shumë prej 300.00 euro, për rehabilitim fizioterapeutik dhe klimatik shumë prej 600.00 euro
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi ndaj të paditurës me kërkesën për anulimin e marrëveshjeve jashtëgjyqësore dhe kompensimin e dëmit material dhe jo material. Në padi ndër të tjera paditësit kanë deklaruar se, paditësit me të paditurën kanë lidhur marrëveshje jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmeve nga aksidenti i datës 03.02.2017 duke u bazuar nga obligimet që dalin nga polica e sigurimit e lëshuar nga e paditura dhe se këtë marrëveshje jashtëgjyqësore palët e kanë arritur pasi që e paditura duke shfrytëzuar

mungesën e njohurive juridike të paditësve ju ka ofruar për nënshkrim një marrëveshje e cila as për së afërmi nuk i kompenson realisht dëmet e shkaktuara nga i siguruari i të paditurës. Në seanca gjyqësore përfaqësuesi i paditësve ka theksuar se paditësit kanë nënshkruar marrëveshjet jashtëgjyqësore tek e paditura mirëpo e njëjta duke e ditur dhe shfrytëzuar mungesën e njohurive juridike për marrëveshje ju ka ofruar shuma shumë të vogla sesa lëndimet e shkaktuara nga ky aksident. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi, seanca gjyqësore dhe fjalën përfundimtare kanë theksuar se e kontestojnë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve sipër nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Tutje, kanë theksuar se e paditura me paditësit kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore me të cilën marrëveshje e paditura në tërësi i ka përmbushur detyrimet ndaj paditësve në bazë të polisës së sigurimit me numër 6034625 dhe se nuk qëndron pretendimi i paditësve se e paditura e ka shfrytëzuar mungesën e njohurive juridike të paditësve për faktin se paditësit gjatë gjithë procedurës administrative kanë qenë të përfaqësuar dhe të këshilluar nga avokati i tyre fakt i cili vërtetohet edhe nga data e autorizimi të revokuar dhe paditësit në të njëjtën ditë pas revokimit të autorizimit ndaj avokatit të tyre janë paraqitur në kompani dhe kanë kërkuar që të nënshkruajnë marrëveshjen jashtë gjyqësore me të paditurën. Tutje kanë shtuar se në marrëveshjet jashtëgjyqësore të nënshkruara me paditësit është theksuar se paditësit marrëveshjen e nënshkruajnë pa qenë në ndikim të lajthimit, kërcënimit apo mashtrimit. Shpenzimet e procedurës nuk i kanë kërkuar.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e provave si në vijim: marrëveshja jashtëgjyqësore me nr.0244-02-17, e datës 13.04.2017, marrëveshja jashtëgjyqësore me nr.0243-02-17, e datës 13.04.2017, raporti policor me numër të aksidentit 2017 – AR – 0284, i datës 03.02.2017 së bashku me skicën, raporti mjekësor i datës 03.02.2017 për Sh.F., dëftesa e datës 07.02.2017, raport i konsultës i datës 07.02.2017, kuponi fiskal i lëshuar nga barnatore Global Pharm, i datës 07.02.2017, raport nga konsulta 07.02.2017, dëftesë 07.02.2017, raport mjekësor për E.D. i datës 03.02.2017, parashtresë për revokimin e autorizimit e datës 13.04.2017, dëshmi e pagesës për Sh.F. e datës 18.04.2017, dëshmi e pagesës për E.D. e datës 18.04.2017, ekspertizë mjekësore për Sh.F. e datës 04.02.2025, ekspertizë mjekësore për E.D. e datës 04.02.2025, njoftim mbi trajtimin e kërkesë e datës 06.04.2017, ankesë e datës 06.04.2014, e dërguar përmes emailit të datës 06.04.2017.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e pabazuar.

Në këtë çështje juridike kontestimore nuk ishte kontestuese se me datë 03.02.2017 paditësit ishin përfshirë në aksident të komunikacionit me të siguruarin e të paditurës. Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësit me të paditurën kishin lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e të gjitha formave të dëmit dhe se e paditura ua kishte paguar përmes transfereve

bankare paditësve shumat e kompensimit siç të njëjtit ishin dakorduar në marrëveshjet jashtëgjyqësore të nënshkruar me të paditurën.

Kontestuese në mes të palëve ishin faktet, nëse e paditura kishte shfrytëzuar mungesën e njohurive juridike të paditësve me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve jashtëgjyqësore dhe nëse paditësit me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve jashtëgjyqësore ishin dëmtuar përtej mase sa i përket shumave të cilat paditësve ju takonin si kompensim për lëndimet e përjetuara nga aksidenti i datës 03.02.2017.

Siç rezulton nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, gjegjësisht nga marrëveshja jashtëgjyqësore me numër 0244-02-17 e datës 13.04.2017 dhe marrëveshja jashtëgjyqësore me numër 0243-02-17 e datës 13.04.2017 këtu palët ndërgjyqëse ishin dakorduar për kompensimin e dëmit material jo material që paditësit kishin pësuar në aksidentin e datës 03.02.2017. Në nenin 1 të këtyre marrëveshjeve është theksuar se paditësit do të kompensohen në shumën prej 404.00 euro për paditësin E.D. dhe 620.00 euro për paditësin Sh.F., në emër të kompensimit të plotë për lëndimet e pësura në aksident, ndërsa në nenin 2 të këtyre marrëveshjeve është theksuar se të dëmtuarit – këtu paditësit – dakordohen se me pranimin e këtyre shumave janë plotësuar të gjitha detyrimet e të paditurës dhe se paditësit nuk kanë asnjë pretendim të mëtejshëm financiar ndaj të paditurës, ndërsa në nenin 4 të marrëveshjeve jashtëgjyqësore theksohet se paditësit marrëveshjet jashtëgjyqësore i kanë nënshkruar pa qenë nën pasojat e lajthimit, kërcënimit apo mashtrimit.

Po ashtu nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor rezulton se e paditura i kishte përmbushur detyrimet e marra me nënshkrimin e marrëveshjeve jashtëgjyqësore, fakte këto të cilat vërtetohen edhe nga lista e dëmeve 18.04.2017, ndërsa një fakt i tillë nuk është kontestuar as nga përfaqësuesi i paditësve në procedurë gjyqësore, në seancën e datës 26.02.2025.

Marrë për bazë faktet e vërtetuara nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësore, gjegjësisht gjendjen faktike të vërtetuar gjykata gjen se paditësit kanë kërkuar anulimin e marrëveshjes jashtë gjyqësore me pretendimin se e paditura duke shfrytëzuar mungesën e njohurive juridike u ka ofruar paditësve nënshkrimin e marrëveshjeve jashtëgjyqësore dhe duke iu ofruar për kompensim shuma të ulta ashtu që kjo rrethanë ka bërë që paditësit të dëmtohen përtej gjysmës së vlerës që të njëjtëve do të iu kishte takuar realisht si kompensim për dëmet e përjetuara nga aksidenti i komunikacionit.

Në këtë kuptim, gjykata fillimisht iu referohet dispozitave ligjore që rregullojnë dëmtimin përtej mase. Kështu Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim referuar si: LMD në nenin 122 paragrafi 1 ka rregulluar si në vijim: *1. Në qoftë se midis detyrimeve të palëve kontraktuese në kontratën e dyanshme detyruese ekziston në kohën e lidhjes së kontratës disproporcion i hapur pala e dëmtuar mund të kërkojë edhe anulimin e kontratës, në qoftë se për vlerën e saktë atëherë nuk ka ditur dhe as që është dashur të dinte* ndërsa me paragrafin 2 të të njëjtës dispozitë është rregulluar që: *2. E drejta për të kërkuar anulimin e kontratës pushon me skadimin e një (1) viti nga lidhja e kontratës.* Nga interpretimi i paragrafit 1 të nenit 122 të LMD-së rezulton se për të kërkuar anulimin e një kontrate për shkak të dëmtimit përtej mase,

fillimisht duhet që kontrata të jetë e dyanshme detyruese, në kohën e lidhjes së kontratës të ekzistojë disproporcioni i hapur në mes të vlerës reale dhe vlerës së pranuar nga pala që pretendon se është dëmtuar, dhe kushti i tretë që pala që pretendon se është dëmtuar përtej mase me lidhjen e kontratës të mos ketë ditur e as që është dashur të dijë për vlerën e saktë.

Në rrethana të rastit konkret, paditësit nuk kanë arritur që në procedurë gjyqësore të argumentojnë me prova relevante se ka ekzistuar disproporcioni i hapur në mes të vlerës së pranuar në emër të kompensimit si pasojë e dëmit të pësuar nga aksidenti i komunikacionit, kjo për faktin se me propozimin e vet përfaqësuesit të paditësve është nxjerrë prova me ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë dhe ortopedisë, ku ekspertët në fjalë në ekspertizën e tyre kanë përcaktuar se paditësit si pasojë e aksidentit të komunikacionit kanë përjetuar lëndime të lehta trupore, andaj me vet faktin se janë konstatuar lëndime të lehta të pësuar, sipas vlerësimit të gjykatës nuk mund të konstatohet apriori se ekziston disproporcioni i hapur në mes të vlerës që paditësit janë kompensuar nga e paditura dhe vlerës që realisht të njëjtëve do të iu takonte, ndonëse paditësit përmes parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë të dorëzuar në seancën e datës 26.02.2025 kanë kërkuar që e paditura të detyrohet për pagesën e shumave më të mëdha se sa ato që kanë pranuar nga e paditura në procedurë jashtëgjyqësore. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se fakti se paditësit në procedurë gjyqësore kanë paraqitur kërkesë për vlera dukshëm më të mëdha se sa ato që të njëjtët janë kompensuar në procedurë jashtëgjyqësore nuk është fakt vendimtar për të përcaktuar se ekziston disproporcioni në mes të shumave të pranuar nga paditësit dhe shumave që të njëjtëve do të mund të iu kishin takuar, ngase paraqitja e kërkesës në procedurë gjyqësore në shumat çfarë janë kërkuar nga paditësit nuk mund të merren si rrethanë e sigurte se të njëjtëve do të iu ishin takuar dhe/ose do të iu ishin njohur këto shuma me vendim gjyqësor. Kjo edhe për faktin se, në marrjen e vendimit lidhur me kërkesën e paditësve, e tillë siç është propozuar nga të njëjtët, gjykata fillimisht kufizohet në vlerësimin nëse janë plotësuar kushtet për anulimin e marrëveshjeve jashtëgjyqësore, pra nëse ekziston disproporcioni i hapur në mes të shumës që paditësit kanë pranuar si kompensim nga e paditura dhe rrjedhimisht gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësimin hipotetik se sa do të ishin shumat që eventualisht do të aprovohehin nga gjykata në emër të kompensimit.

Tutje gjykata vlerëson se paditësit në procedurë gjyqësore nuk kanë argumentuar as kushtin tjetër që derivon nga dispozita e nenit 122 paragrafi 1 *se për vlerën e saktë atëherë nuk ka ditur dhe as që është dashur të dinte*. Kështu paditësit në procedurë gjyqësore nuk kanë argumentuar se në kohën e nënshkrimit të marrëveshjeve jashtëgjyqësore, cilat kanë qenë njohuritë e tyre lidhur me kompensimin, kur nga interpretimi i dispozitës së nenit 122 paragrafi 1 kërkesë ligjore është që paditësit *as që është dashur të dijnë* për vlerën reale eventuale që të njëjtëve eventualisht do të mund të iu kishte takuar vlera e kompensimit për dëmet e pësuar. Për më tepër, nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, rezulton se gjatë negociimit të marrëveshjeve jashtëgjyqësore paditësit kanë qenë të përfaqësuar nga avokati F.M., ndonëse përfaqësuesi i paditësve sipas parashtrësës së datës 13.04.2017 e titulluar parashtrësë për revokimin e autorizimit pjesë e shkresave të lëndës, e ka njoftuar të paditurën që ka denoncuar autorizimin, por që nga provat shihet se marrëveshjet jashtëgjyqësore janë nënshkruar në të njëjtën ditë që përfaqësuesi i paditësve ka denoncuar autorizimin e paditësve (ndonëse në parashtrësë titullohet si revokim). Tutje, përfaqësuesi i paditësve në seancën e datës 26.02.2025

ka pohuar faktin se në procedurë administrative tek e paditura i njëjti ka përfaqësuar paditësit, por që sipas deklaramentit të tij paditësit nuk kanë pranuar ofertën e bërë nga e paditura. Nga marrëveshjet jashtëgjyqësore, gjegjësisht në nenin një (1) të këtyre marrëveshjeve shihet se ka qenë e kontraktuar që paditësit pajtohen se me pranimin e shumës prej 404 gjegjësisht 620 euro, këtë shumë e pranojnë në emër të kompensimit të plotë për lëndimet e pësuar në aksidentin e datës 03.02.2017, andaj meqenëse ka qenë e kontraktuar një klauzolë e tillë dhe paditësit janë dakorduar me këtë klauzolë me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes jashtëgjyqësore, rezulton se të njëjtit janë pajtuar lidhur me shumën e kompensimit. Ndërsa sa i përket faktit nëse paditësit kanë qenë në dijeni për përmbajtjen e marrëveshjes jashtëgjyqësore të nënshkruar me të paditurën, paditësit në procedurë gjyqësore nuk kanë ngritur pretendime që marrëveshjet në fjalë të jenë nënshkruar në lajthim, kërcënim apo mashtrim, e as nuk kanë propozuar marrjen e provave në drejtim të vërtetimit të fakteve të tilla.

Andaj sipas vlerësimit të Gjykatës paditësit nuk kanë arritur të argumentojnë se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 122 paragrafi 1 i LMD për anulimin e kontratave – marrëveshjeve jashtëgjyqësore.

Gjykata po ashtu vlerëson se në rrethana të rastit konkret duhet bërë edhe përcaktimi se marrëveshja jashtëgjyqësore si lloj i kontratës me emër, sipas cilave dispozita të LMD-së rregullohet, ashtu që sipas vlerësimit të gjykatës ky lloj i marrëveshjes – kontratës në LMD është e titulluar si Ujdia dhe është e rregulluar me pjesën XXIX të LMD-së. Në këtë kuptim gjykata përkufizimit ligjor të Ujdisë, të rregulluar me nenin 1047 të LMD-së e cila rregullon si në vijim: *1. Me kontratën për ujdinë në mes të personave në kontest apo të cilët kanë paqartësi lidhur me ndonjë marrëdhënie juridike, kontestet ndërpriten me ndihmën e lëshimeve reciproke, respektivisht eliminohen pasiguritë dhe përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke. 2. Konsiderohet se ekziston një paqartësi edhe atëherë, nëse ushtrimi i një të drejte specifike është e pasigurt, ndërsa me nenin 1048 të LMD-së parashihet: Kur vetëm njëra palë i bën lëshim palës tjetër dhe njeh, p.sh. kërkesën e palës tjetër, atëherë kjo nuk është ujdi dhe nuk i nënshtrohet rregullave të ujdisë.* Siç rezulton nga rrethanat e rastit konkret, gjegjësisht nga provat e administruara, rezulton se paditësit fillimisht nuk kishin pranuar ofertën e të paditurës, por që më vonë të njëjtit kishin pranuar nënshkrimin e kontratës – marrëveshjes jashtëgjyqësore, pra duke bërë lëshime ndaj të paditurës, ndërsa e paditura ka bërë lëshime ndaj paditësve me dakordimin e nënshkrimit të marrëveshjes jashtëgjyqësore duke pranuar nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve përkundër faktit se paditësit kishin refuzuar fillimisht ofertën e të paditurës, andaj marrë për bazë faktin se në anën e të dy palëve ka pasur lëshime reciproke, gjykata vlerëson se marrëveshjet në fjalë i nënshtrohen dispozitave të ujdisë të rregulluar me LMD. Bazuar në konstatimin se sa i përket këtyre marrëveshjeve zbatohen dispozitat e lartcituara të ujdisë, gjykata po ashtu sjell në vëmendje edhe dispozitën e nenit 1052 të LMD-së, e cila përcakton si në vijim: *Për shkak të dëmtimit të pamasë nuk mund të kërkohet anulimi i ujdisë.* Siç rezulton nga dispozita ligjore në fjalë, anulimi i ujdisë gjegjësisht pajtimit jashtëgjyqësor, nuk mund të kërkohet për shkak të dëmtimit të pamasë, andaj sipas vlerësimit të gjykatës kërkesa e paditësve për anulimin e marrëveshjeve jashtëgjyqësore është e pabazuar dhe po ashtu nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore që rregullojnë këtë lloj të kontratës – marrëveshjes.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin Neni 450 të LPK-së, e cila përcakton: *Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.*

Andaj, bazuar në të lartcekurat dhe duke ju referuar nenit 143 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**C.nr.1352/2017 me datë 14.03.2025**

**Gjyqtari**  
**Florian Krasniqi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimi të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.